

VENDIM
Nr. 628, datë 30.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 185, DATË 2.4.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË
REALIZIMIT TË KONTROLLIT MJEKËSOR BAZË PËR SHTETASIT E MOSHËS
35–70 VJEÇ”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 185, datë 2.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 35–70 vjeç”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në titullin e vendimit dhe në të gjithë përmbajtjen e tij, togfjalëshi “35–70 vjeç” zëvendësohet me “mbi 35 vjeç”;

b) Fjalja e parë, e pikës 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratë për financimin e shërbimit të kontrollit mjekësor bazë me shoqërinë aksionare shtetërore, që ofron këtë shërbim, pas përfundimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat nr. 3082/20, datë 7.1.2015, “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grup-moshat 40–65 vjeç”, të ndryshuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama